

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	208/90500-26-5651-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: “Mirëmbajta dhe riparimi dyshemesë së Menzës”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Valmir Loshi B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gurakoc

(Adresa)

Istog

(Vendi)

31000

(Kodi postar)

044-208 136

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Valmir Loshi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

loshi-design@hotmail.com

(Adresa elektronike)

02.09.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontrate: 13.07.2026
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 24.07.2026
Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues: 21.08.2026
Kërkesa për rishqyrtim: 26.08.2026
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 31.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo



5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo



6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo



7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar me datën 21.08.2026 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë GOE ADO Invest SH.P.K.; MEGRANT ING SH.P.K., ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se tenderi juaj përmban çmime që konsiderohen jo-normalisht të ulëta. Për këtë arsye, në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ju ka kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetëse për të vërtetuar realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të ofertuara.

Pas shqyrtimit të sqarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se nuk keni paraqitur analizë konkrete dhe të detajuar të strukturës së kostos, kalkulime financiare apo dëshmi të mjaftueshme që mundësojnë verifikimin objektiv të realizueshmërisë ekonomike të çmimeve të ofertuara.

Në përgjigjen tuaj keni deklaruar në mënyrë të përgjithshme se çmimet e ofertuara janë rezultat i kushteve të favorshme të furnizimit dhe bashkëpunimit me furnitorë, të cilët mundësojnë sigurimin e materialeve me çmime konkurruese në treg. Mirëpo, këto deklarime nuk janë mbështetur me analiza dhe dëshmi të mjaftueshme financiare.

Si dokument mbështetës keni dorëzuar një ofertë financiare nga EDIFLOOR GROUP SH.P.K. për materialin dhe realizimin e punimeve të paraqitura në atë ofertë. Megjithatë, ky dokument, i shqyrtuar së bashku me sqarimet tuaja, nuk përmban zbërthimin e plotë të strukturës së kostos dhe nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme kostot e fuqisë punëtore, transportit, shpenzimeve operative dhe elementeve të tjera përbërëse të çmimeve të ofertuara. Gjithashtu, nuk keni paraqitur ekonomi konkrete të procesit të furnizimit, zgjidhje teknike, metodologji të veçantë apo

kushte jashtëzakonisht të favorshme që do ta arsyetonin nivelin e çmimeve të ofertuara.

Rrjedhimisht, sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara nuk i kanë eliminuar dyshimet e ngritura nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk kanë argumentuar në mënyrë të kënaqshme realizueshmërinë ekonomike të ofertës suaj.

Prandaj, në përputhje me nenin 61 të LPP-së, si dhe me nenin 41.8 dhe nenin 41.10, pika b, të Rregullores për Prokurimin Publik, tenderi juaj refuzohet si tender me çmim jo-normalisht të ulët.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin e ofertës sonë si tender me çmim jo-normalisht të ulët është i pabazuar, pasi nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe konkrete sqarimet dhe dëshmitë që ne kemi dorëzuar.

Në kërkesën për sqarim, autoriteti kontraktues ka kërkuar që të sqarohen, ndër të tjera, struktura e kostos, kushtet e favorshme të furnizimit, ekonomitë në procesin e furnizimit, si dhe të dorëzohen dokumente mbështetëse. Në përgjigjen tonë kemi sqaruar se çmimet janë kalkuluar mbi bazën e kostove reale të materialeve, fuqisë punëtore, transportit dhe shpenzimeve operative, si dhe kemi sqaruar konkretisht se çmimet e materialit kryesor janë rezultat i kushteve tona të favorshme të furnizimit. Për këtë kemi dorëzuar edhe ofertën/faturën nga **EDIFLOOR GROUP SH.P.K.**

Përkundër kësaj, autoriteti kontraktues në arsyetimin e eliminimit vetëm deklaron se nuk është paraqitur “analizë konkrete dhe e detajuar e strukturës së kostos”, pa treguar konkretisht se cilat çmime janë të parealizueshme, cilat kosto nuk mund të mbulohen dhe mbi çfarë kalkulimi ka arritur në përfundimin se oferta jonë nuk mund të realizohet.

Fakti që dokumenti i EDIFLOOR GROUP SH.P.K., nuk përmban strukturën e plotë të të gjitha kostove të kontratës nuk mund të konsiderohet si mangësi, pasi ai dokument është dorëzuar për të dëshmuar çmimin e materialit kryesor dhe jo si pasqyrë e të gjitha kostove të realizimit të kontratës, pasi që kostot e tjera janë sqaruar nga ana jonë në përgjigjen e dorëzuar.

Po ashtu, autoriteti kontraktues pretendon se nuk kemi dëshmuar ekonomi konkrete, zgjidhje teknike apo kushte veçanërisht të favorshme, ndërkohë që në mënyrë konkrete kemi deklaruar kushtet e favorshme të furnizimit dhe kemi paraqitur dokument mbështetës nga furnitori. Nëse AK-ja ka konsideruar se kjo dëshmi nuk është e mjaftueshme, ka qenë e nevojshme të arsyetojë konkretisht pse nuk e pranon atë si dëshmi të çmimit real të furnizimit. Veçanërisht, autoriteti kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë konkrete që dëshmon se çmimet tona nuk mund të mbulojnë materialin, fuqinë punëtore, transportin dhe shpenzimet operative. Pra në asnjë rast nuk është konstatuar asnjë kosto konkrete e pambuluar dhe nuk është dëshmuar se realizimi i kontratës me çmimet tona është ekonomikisht i pamundur.

Për më tepër, ne kemi deklaruar qartë se qëndrojmë pas çmimeve të ofruara dhe se jemi në gjendje ta realizojmë kontratën në tërësi me këto çmime, madje kemi shprehur gatishmëri për rritjen e sigurimit të ekzekutimit si garanci shtesë për autoritetin kontraktues, gjë të cilën e rikonfirmojmë edhe një herë pasi që ne jemi të gatshëm të pranojmë rritjen e vlerës së sigurimit të ekzekutimit deri në atë masë sa AK-ja e sheh të arsyeshme. Edhe kjo rrethanë nuk është trajtuar fare në arsyetimin e eliminimit.

Prandaj, konsiderojmë se autoriteti kontraktues nuk ka dëshmuar se oferta jonë është ekonomikisht e parealizueshme, por është kufizuar në një vlerësim formal të dokumentacionit, duke mos bërë një vlerësim konkret të sqarimeve dhe dëshmimeve të dorëzuara. Rrjedhimisht, kërkojmë që arsyetimi për eliminimin e ofertës sonë si tender me çmim jo-normalisht të ulët të rishqyrtohet dhe oferta jonë të trajtohet në përputhje me dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Kërkojmë nga ana e AK-së që ti analizoj në detaje pretendimet tona ankimore dhe lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa gjatë rivlerësimit të bëhet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave në

përputhje me dispozitat ligjore dhe pastaj të nxjerret një vendim, meritohet sepse në të kundërtën ne jemi të detyruar të vazhdojmë më ankime edhe në instancat tjera më të larta.

Po ashtu duhet cekur fakti se ekziston edhe një praktikë e OSHP-së lidhur me vlerësimin e tenderëve me çmime jo-normalisht të ulëta. Në **Vendimin e OSHP-së nr. 2025/0874**, lidhur me aktivitetin "*Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse*", është trajtuar çështja e vlerësimit të sqarimeve të dhëna nga operatori ekonomik për çmimet e ofertës. Ky vendim dëshmon rëndësinë e vlerësimit konkret të sqarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar në raport me realizueshmërinë e ofertës.

Në rastin tonë sqarojmë se ne kemi dhënë sqarime mbi mënyrën e formimit të çmimeve dhe kemi dorëzuar dokument mbështetës nga EDIFLOOR GROUP SH.P.K. për materialin kryesor. Megjithatë, autoriteti kontraktues nuk ka analizuar konkretisht përmbajtjen e këtyre dëshmive dhe nuk ka shpjeguar se pse ato nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar realizueshmërinë e ofertës. AK është kufizuar në konstatimin se nuk është paraqitur një zbërthim i plotë i kostos, pa treguar se cila pjesë konkrete e çmimit është e parealizueshme dhe mbi çfarë kalkulimi është arritur në këtë përfundim.

Prandaj, në përputhje me këtë qasje, çështja nuk duhet të vlerësohet vetëm nga ekzistenca ose mungesa e një dokumenti të caktuar, por nga përmbajtja dhe mjaftueshmëria e përgjithshme e sqarimeve dhe dëshmive të dorëzuara për të vërtetuar realizueshmërinë ekonomike të ofertës.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit është i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në dispozita konkrete ligjore, përmes të cilave oferta jonë është e përgjegjshme.

Ne me dt.31.08.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që AK-ja në asnjë mënyrë dhe me asnjë fakt konkret nuk e ka dëshmuar të kundërtën e pretendimeve ankimore.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 31.08.2026 nuk qëndron, sepse na ka ngarkuar neve si operator ekonomik me një standard prove që vetë Ligji për Prokurimin Publik nuk e parashikon. Neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i Rregullores për Prokurimin Publik kërkojnë që operatori ekonomik të japë sqarime dhe dëshmi që mundësojnë verifikimin e realizueshmërisë ekonomike të çmimit të ofertuar, por jo që të dorëzojë një "analizë të strukturës së kostos" në një format të paracaktuar që askund nuk përcaktohet me ligj apo me dosjen e tenderit. AK-ja nuk ka specifikuar asnjëherë, as në njoftimin fillestar e as në vendimin mbi rishqyrtimin, se cili element konkret i çmimit (materiali, fuqia punëtore, transporti apo shpenzimet operative) rezulton i pambulueshëm me çmimin e ofertuar. Një konstatim i përgjithshëm se "nuk është paraqitur analizë e detajuar", pa identifikuar se cila pjesë e çmimit konkretisht nuk realizohet dhe mbi çfarë baze llogaritëse, nuk përmbush standardin e një vendimi të arsyetuar në kuptim të nenit 7 të LPP-së. Barra e provës për të përcaktuar se cili çmim është jo-realizueshëm, dhe jo thjesht se dokumentacioni "nuk është i mjaftueshëm" në mënyrë abstrakte, i takon AK-së pasi ky konstatim prodhon pasojën më të rëndë të mundshme përkatësisht eliminimin nga aktiviteti i prokurimit për ne si OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Sa i përket ofertës së dhënë për ne nga kompania EDIFLOOR GROUP SH.P.K., AK-ja ka dhënë një konstatim të gabuar kur e trajton si të vetmen dëshmi që duhej të mbulonte tërë strukturën e kostos. Ky dokument u dorëzua nga ana jonë për ta mbështetur specifikisht koston e materialit kryesor, ndërsa elementet e tjera (fuqia punëtore, transporti, shpenzimet operative) janë sqaruar tekstualisht në përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim, mbi bazën e kostove reale të deklaruara nga ne si OE. Fakti që AK-ja nuk i pranon këto sqarime si "të mjaftueshme" nuk mjafton pasi që AK-ja është dashur të tregonte konkretisht pse llogaritjet e paraqitura nga ne nuk përputhen me çmimet e

tregut ose me kostot reale, gjë që nuk është bërë asnjëherë as në njoftim, as në vendimin për rishqyrtim. Po ashtu, deklarimi për kushte të favorshme furnizimi dhe bashkëpunim me furnitorë nuk është thjesht një pohim i zbrazët, siç e paraqet AK-ja, por është mbështetur pikërisht me ofertën/faturën e furnitorit dëshmi konkrete dhe e verifikueshme për çmimin e materialit, e cila nuk është kundërshtuar në thelb nga AK-ja, vetëm është cilësuar "e pamjaftueshme" pa arsyetim specifik.

Lidhur me gatishmërinë tonë për rritjen e sigurimit të ekzekutimit, saktë është se ky element nuk zëvendëson vetë analizën e kostos, por AK-ja e injoron plotësisht rëndësinë e tij si tregues plotësues i seriozitetit dhe aftësisë financiare të kompanisë tonë për ta përmbushur kontratën një rrethanë që së bashku me sqarimet e tjera, duhej vlerësuar në tërësinë e provave dhe jo të shpërfillej krejtësisht.

Sa i përket Vendimit të OSHP-së nr. 2025/0874, vlerësojmë se arsyetimi i AK-së nuk qëndron. Fakti që secili rast duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave konkrete nuk e bën të parëndësishëm vendimin e OSHP-së, përkundrazi, pikërisht ky vendim është relevant për standardin që duhet të ndiqet gjatë vlerësimit të një oferte me çmim jo-normalisht të ulët. Nga ky vendim rezulton se sqarimet dhe dëshmitë e paraqitura nga OE duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen konkretisht në raport me realizueshmërinë ekonomike të ofertës.

Në rastin konkret, ne kemi paraqitur sqarime për mënyrën e formimit të çmimeve dhe dokument mbështetës (ofertë zyrtare) nga EDIFLOOR GROUP SH.P.K. për materialin kryesor. Megjithatë, AK-ja nuk ka bërë një vlerësim të tillë konkret të këtyre dëshmimeve, por është kufizuar në konstatimin se mungon një zbërthim i plotë i kostos, pra pikërisht standardi i vlerësimit i evidentuar në Vendimin nr. 2025/0874 nuk është zbatuar në rastin tonë.

Theksojmë se praktika e OSHP-së për çmimet jo-normalisht të ulëta nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndryshme varësisht nga operatori ekonomik. Rrethanat dhe provat mund të jenë të ndryshme nga një rast në tjetrin, por detyrimi i AK-së për t'i shqyrtuar dhe vlerësuar ato në mënyrë konkrete duhet të jetë i njëjtë. Për këtë arsye, referimi ynë ndaj Vendimit nr. 2025/0874 është plotësisht relevant dhe nuk synon që rasti ynë të trajtohet si identik me atë vendim, por që i njëjti standard i vlerësimit i përcaktuar nga OSHP-ja të zbatohet edhe në rastin konkret.

Së fundi, pretendimi i AK-së se në kërkesën për rishqyrtim nuk janë paraqitur "kalkulime, analiza apo dëshmi shtesë" e kthen barrën e provës në një kërkesë të papërcaktuar dhe të pafundme, pasi ligji nuk e detyron OE-në të dorëzojë dëshmi të reja në çdo fazë të ankimit, aq më tepër kur dëshmitë dhe sqarimet fillestare adresojnë drejtpërdrejt shqetësimet e ngritura nga AK-ja. Kërkesa e OE-së në thelb ishte që AK-ja të analizonte në mënyrë konkrete dëshmitë tashmë të paraqitura, jo t'i shtonte dokumente të reja pa u treguar konkretisht se çfarë mungon.

Për këto arsye, vendimi i AK-së i datës 31.08.2026 është i pabazuar, pasi mbështetet në konstatime të përgjithshme e jo në një analizë individuale të dëshmimeve tona, duke shkelur nenet 1, 7, 59, 60 dhe 61 të LPP-së, si dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.

Po ashtu ju si AK nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE **Valmir Loshi B.I.**, si e bazuar,

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*